



AVENTURA E BRENDËSHME

EKSPOZITË RRETH PARANDALIMIT TË AKSIDENTEVE TË FËMIJËVE NË SHTËPI QË NGA LINDJA DERI NË MOSHËN 5 VJECARE

Program ndërkantonal mbi parandalimin e aksidenteve të fëmijëve
përkrahjen e shërbimeve të shëndetit shoqëror të kantoneve të Gjenevës dhe Vaud-it



Programme Intercantonal
avec le soutien des services de santé publique

des Accidents d'Enfants
des cantons de Genève, Tessin et Vaud



AVENTURA E BRENDËSHME

Në tërësin e aksidenteve



68%

NË SHTËPI

prej 10 aksidenteve, 4 ndodhin në dhomë të fëmijëve apo në sallon



72.5%

NË PRANI TË NJË PRINDI



66%

JANË RRËZUARJE

ku është nevojitur së paku një konsultim mjekësor

Nga 12 fëmijët e dërguar me urgjencë në Gjenevë¹ :

- 5 u nevojit një konsultim mjekësor
- 6 vazhduan trajtimin e mëtutjeshëm të mjeku
- 1 u shtrua në spital

Në kantonin Vaud² :

- 8500 aksidente në vit
- 17000 konsultime mjeksore
- 430 shtrirje në spital


1. «Studim epidemiologjik mbi aksidentet fëmijërore» IMPS dhe klinika e pediatriisë, Gjenevë, 1996.

2. Sipas V. Addor dhe B. Santos-Eggiman, IUMSP Lausanne, Studime mbi popullsin në kantonin Vaud, 1992.

RREZIQET KRYESORE NË RAPORT ME SHKALLËN E ZHVILLIMIT TË FËMIJUT

Këto informata ndikojnë në zhvillimin e fëmijut mvarësisht nga mosha e tij dhe rrezikut potencial në raport me shkallën e zhvillimit të tij. Fëmijët nuk zhvillohen të gjithë në të njejtën mënyrë. Kjo është krejtësisht normale. Në çdo etapë të zhvillimit, shfaqen rreziqe të reja.

Të mbahen mend tri aspekte :



- Vëzhgojeni fëmijun tuaj për ta kuptuar nivelin e zhvillimit të tij.
- Informohuni se si duhet ta parandaloni rrezikun.
- Mërmirëzoni masa para se të bëhet vonë.



Mjetet e sigurisë

Këto mjete të sigurisë janë të zakonshme dhe të lehta për t'i gjetur në treg. Për disa syresh kërkohen aftësi sajimi për ndonjë instalim adekuat. Mjetet preventive nuk i eliminojnë të gjitha aksidentet por e zvogëlojnë rrezikun.

Të mbahen mend katër aspekte :

- Është e këshillueshme të instalohen disa mbrojtëse edhe nëse nuk vërehet nevoja e përnjëhershme e tyre.
- Këto nuk ju lirojnë që të mos i ipni sqarime të shpeshta fëmijëve mbi shumë rreziqe potenciale.
- Përdorimi i tyre zvogëlon mundësin e aksidenteve.
- Nëse ndodh ndonjë aksident, ta dini se si të intervenoni (shih faqen 10 dhe 12).



DHOMA E FËMIJUT

Muaji i parë

Fëmiju ende nuk di të lëvizë dhe mund të furet, mos i vëni fëmijut qafore apo zinxhir, sidomos kur flen.

Është e preferueshme që asnjë shtazë të mos ngelet në dhomë : mund të ndodh që të shtrihet në djep dhe ta fur fëminë.

E veni në gjum pa jastëk, jastëkun e vendosni nën dyshek, kurse fëmijun, shtrine në shpinë.

Rreth 3 muajsh



Fëmiju fillon të rrotullohet anash.

Nga pozita në shpinë, kalon në pozitë barkas dhe asjelltas.

Qëndroni gjithnjë pranë tij, mos e leni kurrnjëherë vetëm! Zgjedhne një tavolinë për ta shtrirë në mënyrë solide dhe stabile me një jastëk që i ka skajet anësore të larta.

Rreth 6 muajsh

Beba fut në gojë të gjitha gjërat.

Zgjidhni lodra që e kanë madhësinë më të madhe se një top i pinpongut. Të mos ketë farë litari që mund ta mbërrijë.

Fëmiju e ndërron vendin duke ecur zhagas.

Mbroni aparatet e nxemjes dhe kini kujdes në avullin që krijon lagështi të ajrit.

Pengone në prekjen e shtekave elektrik me anë të mbuluesve të shtekave.



Rreth 12 muajsh

Fëmiju zbulon ecjen dhe kënaqësin për tu kacavjerrur.
Vendosne një mbrojtës në dritare për ta evituar hapjen.
Fëmiju ngjitet përherë e më shumë.
Përpiquni që mobiljet tuaja të jenë stabile.
Qëndroni vigjilent, pengone fëmijun që të mos ngjitet në objekte jo stabile.



Rreth 15 muajsh



Fëmiju largohet gjithëherë e më shumë.
Vlersojeni me kujdesë sigurin dhe stabilitetin e lojrave në katër rrota. Kujdes në pengesa : qilim, dysheme me shkallë të lehta, etj.
Kuti me lojëra : me dispozitif i cili pengon mbylljen e rrëmbyeshme dhe që ka një hapësirë për ajrosje.

Rreth 3 vjeç

Fëmiju i juaj fle në një shtrat normal.
Vëni një pengesë anash shtratit, fiksoni për murë shtretërit që vendosen njëri mbi tjetrin.


SHKALLËT



Rreth 6 muajsh

Fëmiju lëviz për toke duke ecur këmbë-doras, vëni një pengesë poshtë dhe/ose në fillim të shkallëve.


Rreth 12 muajsh



Fëmiju mund të mësohet të ngjitet dhe të zbres shkallëve, mësonë, nuk do të rrëzohet aq lehtë, fiksonë një dorëz të zakonshme në lartësinë e tij, ngjitni mbrojtëse në skajet e shkallëve për ta penguar rrëzuarjen.


Rreth 2 vjeç

Fëmiju është çdo herë e më shumë i sigurtë në lëvizjet e tij, ndihmonë në zhvillimin e tij që të jetë sa më i sigurt në lëvizjet që i bënë. Lojërat edukative janë një mjet i mirë për ta stimuluar.



KUZHINA

Që nga ditët e para




Fëmiju nuk mund t'ju thotë nëse (shishja) biberoni është i nxehtë!

E shtrydhni që të rrjedhin disa pika në kyq të dorës suaj.

**Rreth 9 muajsh
Fillon të zhagitet.**

Rradhini prodhimet toksike (helmuese) në një orman, nëse është e mundëshme me një bllokim të sigurt.



Rreth 10 muajsh

Fillon të mbahet në këmbë.

Asnjëherë mos e leni vetëm në ndonjë karrikë të lart.

Sigurone bezin me kapëse.

Mos e lejoni ta kap gajtanin e hekurit për hekurosje.

Rreth 2 vjeç

Fëmiju ka dëshirë t'i imitojë gjestet dhe sjelljet e prindërve të tyre.

Objektet që i përdorni rregullisht e që mund të jenë të rrezikshme për ta, duhet t'i largoni që të mos arrijnë t'i prekin.

Instaloni një mbrojtje para shporetit si dhe qelqit të furrës.

E nxitni të marrë pjesë në punët e shtëpisë duke i dhënë objekte që nuk janë me maje e që nuk prejnë.

Rradhimi veglat me teh në një sirtar që bllokohet, për siguri.

Pas përdorimit, çkyçni aparatet elektrike.



BANJOJA


Që nga lindja

Që nga ditët e para deri në moshën 3 vjeçare, fëmiju mund të zhytet në disa centimetra ujë.

Rreth 6 muajsh

Fëmiju fillon të rrij ulur por nuk është shumë i sigurtë në këtë pozitë.
Mos e pengoni të bredh kur është për toke.

Rreth 9 muajsh



Mund të ecën në këmbë-doras dhe të rrëshqasë në shtrojë të lagur.
Vëni një qilim që nuk rrëshqet dhe një mbajtëse në banjo.


Rreth 10 muajsh

Fëmiju fiton njohuri mbi thellësinë dhe interesohet për vrimat dhe plasat.
Vëni mbrojtëset e shtekave elektrik.

Rreth 12 muajsh

Ilaqet e tërheqin,
Sidomos nëse e kanë ngjyrën e bombonave dhe nëse e shef ndonjë të rritur duke përdorur rregullisht.

*Produktet toksike dhe ilaqet:
Në ormanë në lartësi prej mbi 1,60 m, me një bllokim sigurie.*



Reth 2 vjeç

Mund të digjet me ujë të nxehtë.

Në fillim lëshone të rrjedhë ujin e ftohtë vaskë(kadë); nëse është e mundur, instaloni një termostat apo një robinet përzirës që e rregullon temperaturën.



SALLONI (DHOMA E DITËS)

Rreth 6 muajsh

Fëmiju e fut në gojë çdo objekt.

Kujdes në objektet e vogla ; kurrë mos i leni të bredhin mbi tavolinë ; i vendosni dikund jasht mundësisë që ai të gjejë si : kikirikët, shpuzore, kutinë për rrobaqepsi, etj.



Rreth 9 muajsh


Fëmiju lëviz këmbë-doras dhe prekë çdo gjë.

Mbroni këndet e mobiljeve, vëni ngjitës nën qilim që të mos rrëshqas, fiksonë bibliotekën për murë, instaloni një mbrojtëse të shteteve elektrike.

Rreth moshës
2 vjeçare

Fëmiju ka dëshirë t'i imitojë prindërit e tij në gjestet e tyre dhe sjelljet e tyre.

Objektet që i përdorni rregullisht e që mund të jenë të rrezikshme për të, mos i leni aty ku mund t'i prekë. Pijet alkoolike i vendosni në ndonjë mobilje ku mbyllen me çelës, lulet që janë të rrezikshme i largoni që fëmiju të mos ketë mundësi t'i prekë (shih faqe 10).



BIMËT E RREZIKSHME

Kërkoni nga animatorët(et) e ekspertizës që ta këshilloni broshurën përshkruese me fotografi

«Bimët helmuese të banesave»

Nëse dëshironi, porositni një apo disa broshura :

«Kokrrat helmuese»

«Këpurdat helmuese»

«Barishta mjekësore»



Një ekzemplar kushton Frs. 2.50
Alliance suisse des samaritains
Case postale
4601 OLTEN
Tél. 062/286 02 00

Në rast helmimi :

Telefononi në

117 (polici) apo **144** (ambulanca) apo

në quendrën Tox në Zürich, tél. **145** apo **01 251 51 51**, ditë dhe natë.

Kërkesa për informata jo urgjente :

Tél. 01/251 66 66

Fax 01/252 88 33

Graphisme et illustrations: Kito

Lulet e rrezikshme

Disa lule të banesave apo kopshteve dhe parqeve, mund të paraqesin rrezik nëse fëmiju i përbin kokrrat apo farat (helmin) ose nëse i prek fletët apo lëngun e luleve. Por **nuk ka nevojë të dramatizohet**: një studim mbi përvojën 29 vjeçare të qendrës anti-helmim të Zurich-ut rreth gëlltitjes së pjesëve të ndryshme të bimëve nga fëmijët, dëshmohet se më pak se te 1% e fëmijëve janë paraqitur shenja të helmimit të rëndë. Nuk ka patur asnjë rast vdekje.

Bima e banesës që paraqet rrezik është dieffenbachia (fleta dhe lëngje).

Jasht, sidomos akoniti, bima helmuese (sigy) ujore, bima helmuese (sigy) e madhe , kolshika, digjitalja, if-i, dafina, onanta dhe helmarina.

Nëse fëmiju e ka ngrën ndonjë bimë, duhet provuar që të njiheni rreth asaj se :

- Çka ?	Cila bimë apo cila pjesë e bimës.
- Ku ?	Vendi i incidentit : banesë, kopsht, pyll.
- Sa ?	Sasia e përbirjes.
- Kush ?	Mosha e fëmijut.

Qendra kundër-helmuese në Zürich: 145 apo 01 251 51 51, ditë dhe natë

Për më shumë informata mbi ekspozitën e aksidenteve shëpiake të fëmijëve, drejtohuni përgjigjesve kantonal :

Gjënevë	Tiçino	Vo
Direction Générale de La Santé Publique Avenue Beau-Séjour 24 1206 Genève Tel 022 839 98 30 Fax 022 839 98 50 jean.simos@etat.ge.ch	Ufficio di Promozione e di Valutazione Sanitaria Via Orico 5 6500 Bellinzona Tel 091 814 30 50 Fax 091 825 31 89 dos-upvs@ti.ch	La Boutik santé Bill Chapuisod 12, Avenue de Provence 1007 Lausanne Tel 021 623 37 61 Fax 021 623 37 39 Boutik@fvls.vd.ch

www.pipades.ch

Ndihma e parë

Në rast se rrëzohet

- 1 Duhet me e kontrolluar gjendjen e vetëdijes së fëmijut në mënyrë që të keni mundësi për t'i dhënë informatat e hollësishme shpëtimtarëve (vaj, dremitje, frymëmarrje).
- 2 Në rast se dyshoni që është fjala për thyerje (deformim i dukshëm apo dhimbje) evitoni që ta çvendosni fëmijun.
- 3 Thirreni mjekun tuaj ose telefononi në 114-të.

Në rast lëndimi

- 1 Ndërprene gjakderdhjen me ndihmen e një shtërngese apo me fashë.
- 2 E ngreni më lart atë pjesë të trupit që gjakderdhë.
- 3 Pastrojene dhe dezinfektone plagën.
- 4 Mbulone plagën me një fashë të pastër.
- 5 Thirreni mjekun tuaj ose telefononi në 114-të.

Në rast se i zihet fryma nga një gjësend

- 1 Ja nxirrni gjësendin nga goja.
- 2 E ktheni fëmijun në pozitë me kokë poshtë dhe i mshoni dukshën në shpinë.
- 3 E thirrni mjekun tuaj ose telefononi në 114-të.

Në rast djegje

- 1 E ftohni përnjëherë plagën e djegur duke e mbajtur së paku 10 minuta nën ujë të ftohtë.
- 2 E mbroni me një fashë të pastër pa i hjekur rrobat e fëmijut.
- 3 E thirrni mjekun tuaj apo 114-in.
- 4 Kurr mos përdorni dezinfektuesin, melhem apo pomadë tjetër «shtëpiak», sidomos prodhime të yndyrshme.

Në rast helmimi me acide apo prodhime tjera gërryese

- 1 E ruani prodhimin apo enën që përmban substancën e përbirë që të keni mundësi t'i ipni informatat e hollësishme dhe precize.
- 2 E thirrni Qendrën Tox në Zürich, 145 apo 01 251 51 51.
- 3 I ipni ujë për të pirë apo çaj për fëmijë, përderisa është ende me vetëdije dhe nuk i vie për të vjellur.
- 4 Kurrë mos e nxitni fëmijun të vjellë.

Në rast helmimi

- 1 E ruani prodhimin apo enën që përmban substancën e përbirë që të keni mundësi t'i ipni informatat e hollësishme dhe precize.
 - 2 E thirrni Qendrën Tox në Zürich, 145 apo 01 251 51 51.
 - 3 Mbane fëmijun zgjuar dhe aktiv.
 - 4 I ndiqni udhëzimet e Qendrës Tox apo të shpëtimtarit.
-